



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I ELBASANIT "ALEKSANDËR XHUVANI"
REKTORI

Njoftim për shpallje konkursi të brendshëm

Në Rektoratin e Universitetit të Elbasanit "Aleksander Xhuvani", shpallet konkurs i brendshëm, për personel ndihmësakademik me karakter administrativ. Kandidatët e interesuar, punonjës të kategorisë personel ndihmësakademik dhe administrativ, me kohë të plotë në UE, që plotësojnë kriteret e përgjithshme e të posaçme etj, në respektim të rregullores në fuqi, miratuar me Vendimit nr. 70 datë 17.11.2025 "Për miratimin e rregullores për plotësimin e vendeve të lira të punës të kategorisë personel ndihmësakademik në Universitetin e Elbasanit "Aleksandër Xhuvani" të Senatit Akademik, gjejnë informacionin e mëposhtëm:

Kategoria: personel ndihmësakademik me karakter administrativ në Fakultetin e Shkencave të Edukimit

Pozicioni i punës: *specialist protokoll arkiv.*

Specialisti i protokoll arkiv në njësinë kryesore, organizon, administron sistemin e protokollit dhe arkivës së njësisë kryesore, duke respektuar regjistrimin, shpërndarjen, ruajtjen dhe arkivimin korrekt të dokumentacionit zyrtar në përputhje me legjislacionin për arkivat në fuqi dhe rregulloret e brendshme të institucionit; asiston dekanin dhe dekanatin gjatë ushtrimit të veprimtarisë. Raporton tek Dekani për punën e kryer.

Kandidati duhet të plotësojë këto kriteret e përgjithshme e të posaçme:

Kriteret e përgjithshme:

- Të jetë shtetas shqiptar dhe të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- Të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse;
- Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundërvajtjeje penale me dashje;
- Ndaj tij të mos jetë marrë masë disiplinore e largimit nga puna, që nuk është shuar sipas legjislacionit në fuqi;
- Të plotësojë kriteret e posaçme.

Kriteret e posaçme:

- Të ketë mbaruar studimet universitare të ciklit të parë Bachelor/dytë (Master) ose ekuivalente me të, në shkenca shoqërore. (Diplomat e lëshuara nga Institucione të huaja të Arsimit të lartë, të jenë të njohura dhe njësuar nga Ministria përgjegjëse për Arsimin;
- Të ketë përvojë pune, jo më pak se 3 vjet në fushën e kërkuar;



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI I ELBASANIT “ALEKSANDËR XHUVANI”
REKTORI**

- Të ketë kryer trajnime në fushën e arkivave.
- Të jetë njohës i një prej gjuhëve të huaja të BE-së;
- Të ketë aftësi të mira, menaxhuese, komunikuese e të punës në grup.

Kandidatët e interesuar, në respektim të pikës **d** dhe **e** të nenit 6 “Konkursi i brendshëm” të Vendimit nr. 70 datë 17.11.2025 “Për miratimin e rregullores për plotësimin e vendeve të lira të punës të kategorisë personel ndihmës akademik në Universitetin e Elbasanit ”Aleksandër Xhuvani” të Senatit Akademik, duhet të dorëzojnë në rrugë postare në Universitetin e Elbasanit “Aleksandër Xhuvani” brenda 3 (tri) ditëve pune nga data e shpalljes në www.uniel.edu.al (18.09.2026 deri datë 22.09.2026) dokumentacionin si më poshtë:

- Letër interesi
- Dokumentacion shtesë, veç atyre që ndodhen në dosjen personale.

Dokumentacioni i kërkuar të dorëzohet në protokollin e Institucionit.

Konkursi do të zhvillohet në ambientet e Fakultetit të Shkencave të Edukimit. Komisioni ad-hoc do të vlerësojë paraprakisht kërkesat dhe dosjet e kandidatëve dhe më pas kandidatët do ti nënshtohen intervistës me gojë (24.09.2026 – 02.10.2026). Kandidatët konkurues do të njoftohen elektronikisht për rezultatet paraprake të konkurrimit, orën dhe datën e intervistës dhe për shpalljen/njoftimi i fituesit.